

L I G J
Nr.8539, datë 21.10.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT PËR ZGJATJEN E VLEFSHMËRISË SË
PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MARINËS TREGTARE TË
REPUBLIKËS SË GREQISË PËR PATRULLIMIN E PËRBASHKËT NGA POLICIA
KUFITARE DHE TRUPAT GREKE TË MBROJTJES SË LIMANEVE PËR NJË MBROJTJE
MË TË FRYTSHME TË KUFIRIT BREGDETAR NDËRMJET DY VENDEVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli për zgjatjen e vlefshmërisë së Protokollit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Marinës Tregtare të Republikës së Greqisë për patrullimin e përbashkët nga Policia Kufitare dhe Trupat Greke të Mbrojtjes së Limaneve për një mbrojtje më të frytshme të kufirit bregdetar ndërmjet dy vendeve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2469, datë 28.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

PROTOKOLL
MBI ZGJATJEN E VLEFSHMËRISË SË PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË
MARINËS TREGTARE TË REPUBLIKËS GREKE NË LIDHJE ME PATRULLIMIN E
PËRBASHKËT NGA POLICIA KUFITARE DHE TRUPAT GREKE TË MBROJTJES SË
LIMANEVE PËR NJË MBROJTJE MË EFIKASE TË KUFIRIT BREGDETAR NDËRMJET DY
VENDEVE

Ministria e Rendit Publik e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Marinës Tregtare të Republikës Greke, që këtej e tutje të quajtura Palët,

Duke u bazuar në nenin 18 të Protokollit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Marinës Tregtare të Republikës Greke në lidhje me patrullimin e përbashkët nga policia e kufirit dhe Trupat Greke të Mbrojtjes së Limaneve për një patrullim më efektiv të kufirit bregdetar midis dy vendeve, nënshkruar në Athinë më 9 mars 1998,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Vlefshmëria e Protokollit të përmendur më sipër shtyhet për një periudhë të re prej 180 ditësh. Pas përfundimit të kësaj periudhe, Palët mund të bien dakord për shtyrje të mëtejshme për periudha prej 180 ditësh, nëpërmjet shkëmbimit të notave verbale përkatëse që do të hyjnë në fuqi në datën e

shkëmbimit.

Neni 2

Ky Protokoll do të hyjë në fuqi përkohësisht nga data e nënshkrimit dhe përfundimisht në datën e shkëmbimit të njoftimeve ndërmjet Palëve që informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse.

Bërë në Tiranë, më 24 gusht 1999, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, greke dhe angleze, duke qenë të gjitha tekstet njëlloj autentike. Në raste divergjencash do të mbizotërojë teksti në anglisht.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SHQIPËRISË

Paskal Milo

Ministër i Punëve të Jashtme

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
GREKE

George Papandreou

Ministër i Punëve të Jashtme